Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/657
Datë: 30.11.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2021 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** institucioni "Coiffure School" SH.P.K, me adresë: Rr. Hysni Gashi, EXDC 1LL-C/4 K.P Nr. 4, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 30.11.2021 deri më 29.11.2024, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - **1.1 GRIMER/E,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga katër (4) kandidat në një grup, me dy ndërrime në ditë dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tetë (8) grupe.
   - **1.1 MANIKYRIST/E,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 5 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga dy (2) kandidat në një grup, me dy ndërrime në ditë dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tetëmbëdhjetë (18) grupe.
2. **Ri-akreditohet,** institucioni "Coiffure School", për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 25.07.2021 deri më 24.07.2024, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - **2.1. PARUKERI** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 38 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë në një grup, me dy ndërrime në ditë dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në dy (2) grupe.

1. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit "Coiffure School", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Coiffure School", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK